



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIÇ
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIÇ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly of Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), bazuar në nenin 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës nr.-I-34, të dt.25.04.2016, nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, nr.-I-95, të dt.29.06.2018, nenit 13 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e dt.3 prill 2019, nenit 6 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi Komunal pas shqyrtimit të Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës nr. 02-020-01-38434-25 të dt. 22.12.2025 dhe kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.02-020-01-38430-25 të dt.22.12.2025 si dhe pas shqyrtimit të kërkesës nga MAPL-ja, nr.VI-020-3/9, të dt.26.01.2026 në mbledhjen e mbajtur me dt.29.01.2026 mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozimvendimi nr. 02-020-01-38434-25, të dt.22.12.2025 për Shpalljen – Publikimin në Faqen Zyrtare të Komunës të Listës së përgjithshme të pronës së paluajtshme të Komunës për dhënien në shfrytëzim dhe Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 15-99 vite për vitin vijues 2026.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Lista e veçantë e pronave të paluajtshme të Komunës, të cilat planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026 të verifikuara dhe të përgatitura nga Komisioni.
3. Ky Vendim hyn në fuqi (30) tridhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL-së dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

-T'i dërgohet
-Kryetarit
-Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- DPUKP
- MAPL
- Arkivit



Kryesues i Kuvendit Komunal

Sami Ahmeti